



V E N D I M

Nr.29 Datë 04.03.2008

Per

kërkesën e shoqërisë shoqërisë “ERS-08” shpk për licensim ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimit te energjise elektrike

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, nenin 13, pika 1, germa a, te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 10, pika 1, te ”Rregullores se Procedurave te Licensimit”, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve me Nr. 21, date 04.04.2007, Vendimit te Bordit te Komisionereve Nr. 44, date 24.07.2007, “Rregullores se Praktikes dhe Procedurave te ERE-s” neni 15, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 04.03.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë shoqërisë “ERS-08” shpk për licensim ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhim te energjise elektrike nga keto centrale,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave per shqyrtimin e aplikimit te shoqerise “ERS-08” shpk per licensim ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrik me ere, si dhe te prodhimit te energjise elektrike nga keto centrale.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtoria e Ceshjeve Ligjore dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftojne aplikuesin per dergimin e dokumentave te munguara ne perputhje me kerkesat e “Rregullores per Procedurat e Licensimit”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Për

V E N D I M I N

Nr. Datë 04.03.2008

Per

kërkesën e shoqërisë shoqërisë “ERS-08” shpk për licensim ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimit te energjise elektrike

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
1. Bujar Nepravishta	_____	_____
2. Entela Shehaj	_____	_____
3. Ardjan Haci	_____	_____